



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr 17, date 26/01/2001

**MBI PËRCAKTIMIN E VENDQËNDRIMEVE TE MJETEVE PER
TRANSPORT UDHETARESH ME AUTOBUZ, TAXI, MJETE QE
TRANSPORTOJNE MALLRA PER TE TRETE SI DHE NUMRIN E
NEVOJSHEM PER TAXI 4+1; 8+1**

Këshilli Bashkiak i Tiranës në mbledhjen e tij të dt.26.01.2001 mori në shqyrtim relacionin “Mbi përcaktimin e vendqëndrimeve të mjeteve për transport udhëtarësh me autobusë, taxi 4+1; 8+1”, të paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe në mbështetje të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 Neni 32, Ligjit Nr.8308 dt.18.03.1998 “Për Transportet Rrugore”, neni 35 paragrafi 2 nsi dhe Udhëzimit të Ministrisë Transporteve Nr.142 datë 20.01.1998, Neni 16

V E N D O S I

1. Numri maksimal i Taxi-ve, 4+1 të jetë 250 mjete, ngjyra e tyre të jetë e Verdhë
2. Numri maksimal i Taxi-ve, 8+1 të jetë 300 mjete, ngjyra e tyre të jete e Bardhe dhe e Kuqe sipas Shoqërive Transportuese.
3. Vendqëndrimet e Taxi-ve të jenë sipas tabelës bashkëngjitur.
4. Mjetet Taxi duhet të kenë në të 2 dyert e para të stampuar stemën e Bashkisë

5. Vendqëndrimet për Furgon transport malli deri në 3.5 Ton, aftësi mbajtëse, të vendosen në traktin e Rrugës “Luigj Gurakuqi” duke vazhduar përgjatë harkut të kthesës me një gjatësi 300m duke siguruar 100 vendqëndrime (45’ me aksin e rrugës) si dhe në krahët e Unazës duke filluar nga Ura tek vendi i quajtur Brryli, njëra anë deri tek Ministria e Jashtme dhe nga ana tjetër deri tek Ministria e Shëndetsisë me gjatësi 400m
6. Vendqëndrimet për kamionat nbi 3.5 Ton me karroceri të zbuluar të jenë në traktin e rrugës “Qemal Stafa” nga ish Fabrika e Porcelanit deri në intersektimin me rrugën që të çon në malin e Dajtit. Në traktin e rrugës të ish Ndërmarrjes Kimike në drejtim paralel me rrugën
7. Vendqëndrimet për Trajlerat dhe Maunet Taxi të jenë në traktin e rrugës për në Dajt në vazhdim me I.K.V, paralel me rrugën, me gjatësi rreth 400m.
8. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike, Drejtoria Zhvillimit Ekonomik, Sektori I Liçensave, Drejtoria Projekteve të Infrastrukturës, Sektori Mirëmbajtjes dhe Rregullimit të Trafikut pranë Uzinës “Tirana”
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA